



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje materiale konsumi mjekesore e ndare ne dy lote: Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”.

Fond limit për 12 muaj: **9,088,680 (nente milion e tetedhjetë e tete mije e gjashtëqind e tetedhjetë) Lekë pa TVSH.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale mjekesore te konsumueshme-33140000-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 9,088,680 (nente milion e tetedhjetë e tete mije e gjashtëqind e tetedhjetë) Lekë pa TVSH.

Ndarë në lote: PO

Lot 1: MM1 - Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore: me fond limit 4,557,270(kater milion e peseqind e pesedhjetë e shtate mije e dyqind e shtatedhjetë) Lekë pa TVSH,

Lot 2: MM2- Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore: me fond limit 4,531,410 (kater milion e peseqind e tridhjetë e nje mije e katerqind e dhjetë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor/ **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT të njëjta për të dy lotet

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1

b.Lista e cmimeve te artikujve, sipas shtojces 2

c.Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 8

ç. Sigurimin e ofertes, sipas Shtojces 3 vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës/lotit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 76, 82 dhe 83 të LPP, nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit e kontratave të lotit apo shumës së loteve për te cilat oferton sipas tabelës së mëposhtme. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Nr.	Lot	Vera e kontrates	Sigurimi I ofertes, ne leke
1	Lot 1: MM1 - Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore:	4,557,270 (kater milion e peseqind e pesedhete e shtate mije e dyqind e shtatedhete) Lekë.	91,145.4 (nentedhete e kater mije e njeqind e dyzet e pese pike 4) leke.
2	Lot 2: MM2- Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore:	4,531,410 (kater milion e peseqind e tridhete e nje mije e katerqind e dhjete) Lekë.	90,628.2 (nentedhete mije e gjashteqind e njezet e tete pike 2) leke

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b, 43 pika 3 dhe 43 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e percaktuar në udhezimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore **brenda dates 31 mars të vitit pasardhës.**

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit të lotit për të cilat oferton, sipas tabelës në pikën 2.2.1.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se .40% të vlerës së fondit limit të lotit që oferton, vlerë e cila është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është në përputhje me përcaktimet e RRPP nën 40 pika 4:

"4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogarit të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Eshtë kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **sa 40% të fondit limit/(të lotit apo shumës së loteve për të cilat ofertoni operatori**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2. Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese, kjo të plotësohet në Shtojcën 2. Listat e Çmimeve të artikujve të DST.

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancojë se furnizimet të mallit objekt prokurimi.

3. Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 për import/eksport/tregetim të pajisjeve mjekësore /ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatese, të vlefshme. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter vihet në përputhje me pikën 1 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” lidhur me kualifikimin profesional dhe aftësinë teknike dhe me pikën 3 të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent, ose ISO 13485 ”Per Sistemin e menaxhimit të cilësive për pajisjet mjekësore”, /ose ekuivalent/, të vlefshme, për prodhuesin/t e artikujve të ofruar/ose/ deklaratë mbi disponimin e certifikatës. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

5. Ofertuesi duhet të paraqesë Certifikatë konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, (të përditësuar), për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuar ose certifikate FDA, të përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 3 dhe 6/c të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Certifikimi CE i këtyre materialeve është obligator në zbatim të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” (nenit 17 dhe 18) si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”, si dhe rekomandimeve të APP-se për vendosjen e FDA-se.

6. Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku në çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejjimin e tregëtimit të artikujve të tij. (të perkthyer dhe të noterizuar)

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me pikën 1 të nenit 77 (aftësia teknike) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe me pikën 3 të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

7.Operatori duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të leshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me nenin 21 “Autorizimi për tregtim të pajisjeve mjekësore” i Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

8.Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Shtojcën 2. Listat e Çmimeve të artikujve dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për fotografitë ose katalogët teknike, me qëllim verifikimin e plotësisht të specifikimeve teknike.

9. Kërkohen mostra për të gjithë artikujt e kërkuar

Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitali Rajonal Kukes, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit «Blerje materiale konsumi mjekësore e ndare në dy lote: Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj» dhe jo para datës 26.02.2024, ora 10:00.

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 2).

- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 2).

Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, e cila dorëzohet vetëm elektronikisht. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me piken 6/a të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për mostra të mallit, me qëllim verifikimin e plotësimit të specifikimeve teknike. Gjithashtu kërkesat e cilësisë janë vënë në përputhje me nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

III. Argumentimi i specifikimeve teknike(sipas proces-verbalit nr.244 date 07.02.2024 të grupit të punës për perlloraritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike).

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

MM1 - Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore

Nr	Artikulli	Specifikime teknike	Njësia
	Garza, Bende, te tjera konsumable te përgjithshme		
1	Bende 7cm x 4 m	100% pambuk absorbent, dendësia 24x20	Copë
2	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendësia 24x20	Copë
3	Bende elastike 7.5cm x 4m	100% pambuk elastik, pesha 80-90g/cm ²	Copë
5	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitesë e mbrojtur me leter të shqiteshme	Copë
6	Bende 20 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendësia 24x20	Copë
7	Bende allcie 15cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë
10	Komprese sterile 5cm x 5cm	100% pambuk absorbent, dendësia 24x20, 6pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
11	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pambuk absorbent, dendësia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
12	Komprese sterile 10cm x 20cm	100% pambuk absorbent, dendësia 24x20, 8pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
16	Komprese antimikrobiale 10x10cm	E perbere prej materiali absorbues te imprenjuar me polyhexanide / Ag.	Copë
17	Hemostatik kolageni i absorbueshem	Siperfaqe 100-110 cm ² , me origjine nga tendinet e kuajve, 2.8 mg/cm ² fibrile kolageni ose ekuivalent	Copë
18	Garze abdominale	Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensiononi i nje pale 45x45cm, dendësia 28x28, me funde te qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako	Copë
19	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendësia 24x20	m. linear
20	Fiksues kanjule	Fiksues kanjule / afersisht 8.5 cm x 6 cm / materjali , TNT adezive hipoalergjik /poliuretan dhe me garze perthithese ne mes, me kompresim te dyfishte .	Copë
21	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofili, pakete 100g	Copë

23	Leukoplast 5cm x 5m	cope 100% pambuk, ngjites me permbajtje oksid zingu	Copë
24	Leukoplast antialergjik 5cm x 5m	cope e padeptueshme mendafshi, me ngjites antialergjik	Copë
26	Solucion pastrimi per optike	Per pastrimin e lenteve, siperfaqeve optike dhe fibrave optike te endoskopeve. Tubet 4-5 gram.	Copë
	Sisteme dhe doreza		
27	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shishet edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer luck + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP flow rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar .	Copë
28	Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit)	Josterile , me latex natyral , me puder , me permasa XS, S, M, L.	Copë
29	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me rreze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN; madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5	pale
30	Lama bisturie	Nr: 15, 20, 21, 22, 23, 24	Copë
	Materiale konsumi per respirim, aspirim, infuzion		
31	Filter baktericid	per respirim artificial, antibakterial, HMEF	Copë
35	Maske oksigjeni	me zgjatues L=1.5-2m	Copë
36	Sonde oksigjeni adult	nazale, adult, L=1.5-2 m	Copë
37	Sonde oksigjeni pediatrike	nazale, pediatrike L=1.6+0.6 m, diam .4 mm	Copë
41	Set drenimi Redon me vakum ne forme fizarmonike 500-800ml Komplet redoni G 12-22	Set=(ballon vakumi+form z fold tub+dren+troakar)	set
57	Intraduktor jugular	per adulte	Copë
59	Lageshtues per CPAP	Me tub konektor	Copë
76	Urinokol pediatrik		Copë
80	Zhgute		Copë
82	Tuba endotrakeale adult	ID 5.5mm-8.5mm, nazal/oral, me ballon	Copë
83	Kateter aspirimi pediatrik	Ch 8, 10	Copë
85	Kateter aspirimi pediatrik me kontroll vakumi	Ch 8, 10	Copë
	Materiale konsumi per monitorim diagnostike		
102	Leter printeri ECHO		Copë
105	1-3 kanale		Copë
106	3-kanale		Copë
107	6-12 kanale		Copë
110	Xhel per ECHO	Bidone 5 kg , Xhel - Transonic / Transparent , densiteti - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona	Copë
112	Elektroda monitorimi EKG	Elektroda monitorimi njepedorimeshe	Copë
115	Aparat tensioni	Me manometer	Copë
116	Steto-fonendoskop	Koke e sheshte	Copë
118	Termometer	termometer pacienti	Copë
119	Spatula (druri)	Sterile, e paketuar individualisht	Copë

122	Gojez spirometrike		Copë
139	Mansheta monitorimi TA	Per monitore pacienti. Shumeperdorimesh	Copë

MM2 - Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore

Nr	Artikulli	Specifikime teknike	Njësia
	Materiale mjekimi per Anestezi -reanimacion		
3	Kanjule intravenoze	18G , me valvol	Copë
4	Kanjule intravenoze	20G , me valvol	Copë
5	Kanjule intravenoze	22G , me valvol	Copë
6	Kanjule intravenoze	24G, me valvol	Copë
8	Age spinale e zakonshme	22G - 26G, L=7-9 cm	Copë
9	Age spinale atraumatike	Pencil point; 22G - 26G; L=7-9cm	Copë
15	Kateter Foley 2-rruge	Silikon Foley Ped-adult 2-rruge 12G-20G	Copë
18	Sonde gastrike		Copë
19	Sonde rektale		Copë
20	Sonde rektale pediatrike		Copë
21	Qese urine	2000ml, me valvol	Copë
25	Kanjule trakestomie	4, 4.5, 5.5, 6 mm me ballon	Copë
31	Kateter urinar	2 rruges, 12 ch, balon 10 ml	Copë
32	Kateter urinar	2 rruges, 16 ch, balon 30 -50 ml	Copë
34	Kateter urinar	2 rruges, 18 ch, balon 30-50 ml	Copë
35	Kateter urinar	2 rruges, 14 ch, balon 30-50 ml	Copë
38	Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, pa fibra, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 10 cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2.5 cm	Copë
39	Sfungjer Nazal pa fill me tub ajrimi	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, trashesi 1.5 cm dhe lartesi 3 cm	Copë

40	Sfungjer Nazal me fill	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2 cm	Copë
	Shiringa, Age		Copë
42	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë
43	Shiringa 20cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë
44	Shiringa 10cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 21 G , 3 pjese,	Copë
45	Shiringa 5cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 22 G , 3 pjese,	Copë
46	Shiringa 2cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 23G , 3 pjese,	Copë
48	Age 18G	sterile	Copë
49	Age 20G	sterile	Copë
50	Age 21G	sterile	Copë
51	Age 23G	sterile	Copë
55	Age flutur 22G	sterile	Copë
56	Age flutur 24G	sterile	Copë
	Materiale nje perdorimeshe per kirurgji		
62	Kapuc per infermjere	Cope e pathurur me peshe jo me pak se 25 gr.m ² me fund elastik , pa latex.	Copë
63	Qese per veshje kepucesh	Qese PVC, me mbyllje elastike	Copë
64	Beze kirurgjikale sterile 50x75cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m ² , me permasa 50x75cm	Copë

67	Beze kirurgjikale sterile me vrime 200 x 250 cm	Cope e pathurur e veshur me polietilen, jo invazive, me peshe jo me pak se 35 gr/m ² , me vrime rrethore , me diameter 10 cm , me buze adesive, me permasa te copes 200 x 250 cm	Copë
68	Beze kirurgjikale sterile me vrime 75x90cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, jo invazive, me peshe jo me pak se 35g/m ² , me vrime rrethore , diameter 5 cm , me buze adesive, me permasa te copes 75x90cm	Copë
69	Beze kirurgjikale sterile me vrime (100 x 150cm)	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, jo invazive, me peshe jo me pak se 35g/m ² , me vrime rrethore , me diameter 10 cm , me buze adesive, me permasa te copes 100 cm x 150 cm .	Copë
	Sutura Sintetike te Absorbueshme		
94	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 1; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë
96	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 2- 0; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioni i ageve 30-40	me age 1/2 rrethore	Copë
97	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 3- 0; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
98	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 4- 0; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
107	Poliglctin ose PGA , Coated me absorbim te shpejte-USP3-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30 mm	me age 1/2 rrethore	Copë
	Suture Polipropileni		
123	Polypropylene-USP0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore	Copë
125	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë
	Sutura PVDF e verdhe		
149	Shirit Polyester i pa absorbueshme per serklazh 0.5cm	Per tarjtimin e qafes se mitres gjate shtatezanise sipas teknikes Shirodkar, gjatesi 50cm, me dy age 65mm ne te dy anet e shiritit	Copë
	Mesh kirurgjikale per hernia-laparaskopi.		
171	Dezinfektant instrumentesh me baze Glutaraldehyde-Formaldehyde	Per dezinfektimin manual te instrumenteve kirurgjikale, perfishire endoskopet dhe fibroskopet. Te kete efekt baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral (perfishire HBV/HIV)Te furnizohet si komplet me solucion e pa - aktivizuar dhe aktivizuesin per perzierjen dhe perfitim e	litra

		solucionit te gatshem per perdorim.Permbajtja: min. 2% glutaraldyhe, etj. Te furnizohet si solucion i gatshem per perdorim (max 5 litra / ene). Te kete referenca perdorimi nga firmat e njohura te endoskopeve dhe fibroskopeve	
172	Solucion i koncentruar enzimatik	Per pastrimin e mbetjeve ne intrumentat mjekesore-kirurgjikale, vecanerisht endoskopet dhe instrumentat mjekesore dhe kirurgjikale me pjese te levizeshme dhe lumene te vegjel.Te kete baze enzimatiqe. Te furnizohet si koncentrat per tu holluar me uje ne masen 1-3% . Te jete efektiv per pune ne uje me temperature te zakonshme (~20°)	litra
177	Peroksid Hidrogjeni 3%	Peroksid hidrogjeni 3% e vellimit . Per perdorim te te plageve te jashteme , i gatshem per ta perdorur	litra

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP:

“38/b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrimi i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzimi i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT